



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT
K R Y E T A R I**

Nr. 1230/12 Prot.

Tiranë, më 30/ 04/ 2017

V E N D I M

Nr. 40, Datë 30/04/2017

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PEQIN DHE 4-ISH KOMUNAT
PËRPARIM,KARINË, GJOCAJ DHE SHEZË “MBI ZBATIMIN E
LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE” PËR
PERIUDHËN 01.01.2013 deri 31.12.2016.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Njësive të Qeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, dhe mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar” të ushtruar në Bashkinë Peqin, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2016, sipas programit të auditimit nr. 1230/1 datë 15.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A.MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga administrata e Bashkisë Peqin nuk njihen plotësisht dhe nuk janë implementuar kërkesat me 5 komponentët e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Bashkia Peqin nuk ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, në zbatim të nenit 8, të ligjit, si më poshtë;

-nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe nuk janë realizuar takime në lidhje me mangësitë që shqetësojnë njësinë në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-nuk ka një kuptim të qartë të menaxhimit të riskut, nuk ka strategji të riskut apo identifikim të tij sipas nenit 21 të ligjit.

-nuk është formuluar deklarata e vizionit dhe misionit të njësisë në të cilën përcaktohen objektivat strategjike afatgjatë për Bashkinë Peqin në zbatim të kërkesave të VKM-së nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020”.

1.1.Rekomandim: Bashkia Peqin të marrë masa për njohjen nëpërmjet trajnimeve nga të gjithë punonjësit dhe implementimin e kërkesave kryesore që burojnë nga ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të ngrëjë grupin e menaxhimit strategjik (GMS), të formulojë deklaratën e vizionit dhe misionit të njësisë, të hartojë regjistrin e riskut në mënyrë që të identifikohen, vlerësohen dhe kontrollohen ngjarje të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të institucionit.

Në vijimësi

2-Gjetje nga auditimi: Bashkia Peqin nuk ka krijuar njësinë e auditit të brendshëm publik, siç përcaktohet në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”.

2.1-Rekomandimi: Bashkia Peqin të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në përputhje me ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm publik” neni 10 “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në Pasqyrat financiare të konsoliduara (Bilancet kontabël) më datën 31.12.2015 nuk ishin pasqyruar të dhënat e ish-Komunën Pajovë, për arsye se komisioni i krijuar nga Bashkia Peqin për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të ish-Komunën Pajovë, nuk i ishte paraqitur dokumentacioni kontabël për aktivitetin financiar të kësaj komune si, dokumentacioni i kryerjes së pagesave të kryera, nëpërmjet Arkës, Bankës, dokumentacioni i taksave, investimeve etj). Ndërkohë që nga ana e këtij komisioni nuk i ishin kërkuar zyrtarisht dhe në rrugë ligjore personave përgjegjës dorëzimi i dokumentacionit kontabël, në kundërshtim me:

-Udhëzimin e përbashkët të Ministrit për çështjet vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat,afatet kohore, standartete dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

3.1.Rekomandim: Bashkia Peqin të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një komisioni të përbashkët, për inventarizimin, sistemimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit financiar të ish-Komunës Pajovë, në përputhje me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e

qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” dhe në përfundim të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i kryer rezultoi se përzgjedhja e kandidatëve të policisë së Bashkisë nuk është bërë plotësisht konform legjislacionit në fuqi për arsye se Bashkia Peqin nuk kishte lidhur kontrata tre vjeçare me punonjësit e policisë.

-Punonjësit e policisë bashkiake nuk ishin aplikuar gjopa ndaj shkelësve të ligjit, por janë mjaftuar vetëm me mbajtjen e akt kontrolleve.

-Nga Policia Bashkiake lidhur me bashkëpunimin me Zyrën e Tatim/Taksave nuk ishin dokumentuar për çdo rast kontrollet e ushtruara mbi territorin nën administrim të saj për vjeljen e të ardhurave vendore pasi kjo strukturë nuk kishte evidenca të subjekteve të licencuara dhe të palicencuara.

-Nga Policia Bashkiake nuk janë dokumentuar për çdo rast kontrollet e ushtruara mbi territorin nën administrim të kryera në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes të Territorit Vendor.

4.1 Rekomandim : Bashkia Peqin të lidhë kontrata me afat tre vjeçar me punonjësit e policisë Bashkiak dhe në çdo rast ndaj shkelësve të ligjit Policia bashkiake të aplikojë gjopa, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi. Në të ardhmen për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore të bashkëpunojë me Zyrën e Tatim/Taksave.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi : Bashkia Peqin deri më 31.12.2015, ka patur në pronësi të saj 3 mjete transporti dhe pas bashkimit të njësive administrative, Shezë, Pajovë, Gjocaj dhe Karinë, janë shtuar edhe 5 mjete të tjera. Nga të dhënat e paraqitura rezulton se pjesa më e madhe e tyre janë tejet të amortizuara dhe nuk janë në gjendje pune.

5.1 Rekomandim : Bashkia Peqin, të krijojë një komision me pjesëmarrjen edhe të specialistëve teknikë, duke bërë vlerësimin e gjendjes teknike të mjeteve të transportit dhe të ndiqen procedurat për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit.

Brenda muajit Qershor 2017

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Peqin dhe ish-Komunat në përbërje të kësaj Bashkie rezultoi se nuk kanë kryer procedurën e plotë për regjistrimin pronave pranë ZVRPP Peqin, në kundërshtim me kreun IV nenet 13 dhe 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” .

6.1 Rekomandim: Bashkia Peqin të marrë masat për evidentimin dhe dërgimin për regjistrimin në ZVRPP Peqin të pasurive të paluajtshme të cilat janë transferuar pranë pushtetit vendor me VKM.

Në vazhdimësi

7.Gjetje nga auditimi: Në 3 investimet e audituara në Bashkinë Peqin dhe ish-Komunat, nga verifikimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike si dhe nga verifikimi rezultuan mangësi në dokumentacion. Në kundërshtim me UKM nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 4, paragrafi 4.

7.1 Rekomandim: Bashkia Peqin, të marre masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre. Ky monitorim të kryhet nëpërmjet ngritjes së grupeve me specialistë përkatës, në varësi të llojit të investimit, lidhur me dokumentacionin e objektit, zërat e punimeve, dokumentimin nëpërmjet materialeve fotografike të proceseve të maskuara si dhe kontrollin e cilësisë së materialeve në përputhje me kërkesat e projektit. Dosjet teknike të objekteve të përfunduara të merren në dorëzim nga zyra e autorizuar sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë vetëm pas plotësimit të tyre në përputhje me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011, pika, 4 paragrafi 4.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Peqin dhe 5 Njësitë Pajovë, Përparim, Gjocaj, Sheze dhe Karinë në fund të vitit 2016, janë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 214 subjekte, në shumën **10,609,701** lekë, respektivisht;

-në vlerën 6,449,878 lekë, nga mospagesa e 119 subjekteve biznesi i vogël

-në vlerën 4,159,823 lekë, nga mospagesa e 15 subjekteve biznesi madh

Për vjeljen e këtyre debitorëve Sektori i Taksave Vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me nenet 4, 26, 32 dhe 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve.

-Nuk janë pasqyruar në Bilancet kontabile e gjithë vlera e debitorëve të taksave të ish-komunave, në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe pikën 3 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”.

-Nuk janë dorëzuar nga ish-komunat, listat e debitove të bizneseve dhe taksës së popullatës, si taksën mbi tokën bujqësore, taksën mbi ndërtesat, etj

8.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës dhe Sektori i Taksave në Bashkinë Peqin, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 214 subjekte debitorë në shumën **10,609,701 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b - Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

d-Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë (Sektori i taksave dhe Drejtoria Juridike) të marrë masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhej kallëzim penal sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

e- Sektori i taksave në Bashkinë Peqin të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të popullatës, taksës tokës nga

fermerët e 4 Njësive Administrative. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë Peqin dhe 4 njësitë Administrative) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimi me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifave etj

f.Nga Zyra e taksave, Drejtoria Juridike dhe Financë-Buxhetit, tu kërkohet zyrtarisht ish-punonjësve të komunave dorëzimi i listave të debitorëve të bizneseve dhe taksës së popullatës (si taksën mbi tokën bujqësore, taksën mbi ndërtesat, etj).

(Listat e debitorëve për Bashkinë Peqin dhe 4 Njësitë Administrative gjenden pranë Drejtorisë të Taksave Bashkia Peqin, te printuara dhe në mënyre elektronike (Aneksin nr. 1, bashkëlidhur Raportiti Përfundimtar të Auditimit).

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 3 vjeçare 2013-2016 në Bashkinë Peqin nuk janë realizuar të ardhurat nga taksat dhe tarifave në vlerën 25,226,000 lekë. Bashkia Peqin edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjellës sh.a Peqin dhe për vitin 2016 kanë patur përfaqësues në Këshillin Administrativ të krijuar kohët e fundit, ndërkohë nuk ka mundur lidhjen e një marrëveshje, në të cilën Ujësjellësi sh.a. Peqin të përcaktohet si agjent tatimor, për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Peqin të shikojë mundësinë e bashkëpunimit duke lidhur aktmarrëveshjen me Ujësjellës sh.a. Peqin, për caktimin e këtij të fundit si agjentit tatimor, për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,030,610 lekë, si më poshtë:***

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion i Rrugës Ymer Beheluli*” Peqin, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,030,610 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve datë 17.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Peqin dhe OE “L...” sh.p.k si dhe me kontratën e mbikëqyrjes së punimeve.

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Peqin të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,030,610 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “L...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. – prot., datë 17.06.2016 me objekt “*Rikonstruksion i Rrugës Ymer Beheluli*” Peqin, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

B/1.SHPENZIME ME EFEKT NEGATIV NË BUXHETIN E BASHKISË

Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “*Ndërtim i rrugës Ymer Beheluli*”, KVO me përzgjedhjen e ofertës fituese ka vepruar në kundërshtim me Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 8, “ Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike”, gërma (a), gërma (b), ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, gërma a,b,c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, gërma a, b dhe c, dhe neni 20 “Mosdiskriminimi”, neni 53, pika 4, veprim i cili ka sjell impakt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Peqin në vlerën **46,633,507 lekë**.

Rekomandimi: Bashkia Peqin të eliminojë praktikën që çojnë në efektivitet të ulët të prokurimeve për mallra e shërbime dhe për të ardhmen të mos kualifikojë Operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kërkesat për kualifikim .

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE:

1.Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në shkronjën (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Ilojet e masave disiplinore” shkronja “b” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat **g** dhe **k** të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Peqin, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

c.1“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, për 2 punonjësit si më poshtë:

1.Xh.L. me detyrë Drejtore e Financë-Buxhetit,për shkeljet e mëposhtme:

2. G.C. me detyrë drejtor i drejtorisë juridike

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në cilësinë e anëtarëve të grupit punës të krijuar nga Bashkia Peqin, edhe pse ish-Komuna Pajovë nuk kishte paraqitur dhe dorëzuar këtij grupi, dokumentacionin fizik për gjithë aktivitetin financiar të saj, (si, ai i pagesave të kryera për investime e shërbime, nëpërmjet bankës dhe arkës , etj), nuk kanë propozuar dhe kërkuar masat e nevojshme ligjore ndaj personave përgjegjës, *në kundërshtim me:*

-VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

-Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë për çështjet vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat,afatet kohore, standartete dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”.

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

Drejtores e financë buxhetit znj. Xh.L. edhe për mos pasqyrimin në Bilancet kontabël të viteve 2015 dhe 2016 të gjithë vlerën e debitorëve të taksave të ish- komunave, në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe pikën 3 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”.

c.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në shkronjën (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Peqin të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 8 punonjësit, si më poshtë:**

1.Sh.H. në cilësinë e K/Inspektorit të Policisë Bashkiake

2.A.B. në cilësinë e Inspektorit të Policisë Bashkiake

3.Z.M. në cilësinë e Inspektorit të Policisë Bashkiake

4.L.K. në cilësinë e Inspektorit të Policisë Bashkiake

Për shkeljet si më poshtë:

-punonjësit e policisë bashkiake nuk kishin aplikuar gjoba ndaj shkelësve të ligjit, por janë mjaftuar vetëm me mbajtjen e akt kontrolleve.

-nuk kishin dokumentuar për çdo rast kontrollet e ushtruara mbi territorin nën administrim të saj për vjeljen e të ardhurave vendore dhe nuk kishte evidenca të subjekteve të licencuara dhe të palicencuara.

-nuk kanë dokumentuar për çdo rast kontrollet e ushtruara mbi territorin nën administrim të kryera në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes Vendor të Territorit.

5.L.Z. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Blerjeve të Vogla , në ish Komunën Përparim, aktualisht në detyrë, për shkeljet e procedurave të blerjeve në vlera të

vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar me ligjin nr. 22/2012 dhe ligjin nr. 131/2012, Kreu VI, pika 2 “Prokurimi me vlerë të vogël”; Udhëzimin e KM nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, pikat 4 dhe pika 5; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011”Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

6. L.R. në cilësinë e kryetarit të grupit të punës për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të ish-komunës Pajovë, për shkeljet e mëposhtme:

-Në cilësinë e anëtarit të grupit punës të krijuar nga Bashkia Peqin, edhe pse ish-Komuna Pajovë nuk kishte paraqitur dhe dorëzuar këtij grupi, dokumentacionin fizik për gjithë aktivitetin financiar të saj, (si, ai i pagesave të kryera për investime e shërbime, nëpërmjet bankës dhe arkës , etj), nuk kane propozuar dhe kërkuar masat e nevojshme ligjore ndaj personave përgjegjës, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

-Udhëzimin e përbashkët të MCV dhe MF nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standarteve dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

7.B.K. me detyrë Përgjegjës i zyrës taksave

8.E.L. me detyrë inspektor i Tatim-Taksave,

Për mos marrjen e masave dhe zbatimin e procedurave tatimore me pasojë mos arkëtimin e taksave më datën 31.12.2016 nga 215 subjekte në vlerën **10,609,701** lekë.

-në vlerën 6,449,878 lekë, nga mospagesa e 119 subjekteve biznesi i vogël

-në vlerën 4,159,823 lekë, nga mospagesa e 15 subjekteve biznesi madh

Në kundërshtim me nenet 4, 26, 32 dhe 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve

-Nuk kanë kërkuar nga ish-komunat listat e debitorëve për taksat e bizneseve dhe tokës bujqësore për periudhën 31.12.2012 deri më datën 31.12.2015 dhe nuk i kanë dërguar në zyrën e financës për ti pasqyruar në Bilancet kontabile.

C/IV. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për

Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D. 1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 1, 2, 20, 45, 53, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. 10, 12, 16, 18, 19, datë 03.03.2017, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **12 punonjësve** si më poshtë:

I. Bashkia Peqin, për 6 persona si më poshtë:

- 1.G.C.** me detyrë Drejtori i Drejtorisë Juridike, me cilësinë e anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, për shkelje në 1 procedurë të prokurimit publik
- 2.R.T.** me detyrë Drejtoreshë e Urbanistikës, me cilësinë e anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, për shkelje në 1 procedurë të prokurimit publik
- 3.Xh.L.** me detyrë Drejtoreshë e Financë-Buxhetit, me cilësinë e anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, për shkelje në 1 procedurë të prokurimit publik
- 4.J.M.** me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Peqin, me cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 2 procedura të prokurimit publik
- 5.O.S** me detyrë specialiste finance, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
- 6.E.Ll.** me detyrë inspektor i Tatim-Taksave, me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave , për shkelje në 2 procedura të prokurimit publik.

II. Ish Komuna Përparim për 6 persona si më poshtë:

- 1.D.K.** me cilësinë e anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit të ish Komunës Përparim, për shkelje në 1 procedurë prokurimi.
- 2.G.H.** me cilësinë e anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit , për shkelje në 1 procedurë prokurimi.
- 3.Y.B.** me cilësinë e anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit për shkelje në 1 procedurë prokurimi.
- 4.L.O.** me cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për shkelje në 2 procedura prokurimi.
- 5.Xh.Ll.** me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për shkelje në 2 procedura prokurimi.

6.L.Z. me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për shkelje në 2 procedura prokurimi.

Shënim: Në mënyrë të hollësishme shkeljet nga 12 personat në Bashkinë Peqin, për të cilën janë rekomanduar masat administrative në APP dhe referenca ligjore për secilin punonjës trajtohen në Aneksin nr. 1 -Sqaruese mbi masat administrative, bashkëlidhur këtij P/Vendimi.

D.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV)

Nga Bashkia Peqin të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, për shkelje të nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i **kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, të vendosë masë administrative me gjobë për mbikqyrësin e punimeve, *si më poshtë:*

1. **ing. I.D.** përfaqësues ligjor i subjektit “L...” sh.p.k gjobë në masën **50,000 lekë**.

-Për mos kontrollin e zbatimit të punimeve nën cilësinë e mbikqyrësit të punimeve në objektin “*Rikonstruksion i Rrugës Ymer Beheluli*” Peqin, me pasojë raportime dhe financime punime të pakryera dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Peqin në vlerën 1,030,610 lekë pa tvsh, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve 17.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe OE “L...” sh.p.k si dhe kontratën e lidhur për shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve.

E. Në zbatim të nenit 15, shkronja (i) të ligjit nr.154/2014,datë 27.11.2014 " Për organizimin dhe funksionimin e KLSH" dhe nenin 25 të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Auditimi i Brendshëm Bashkia Peqin apo një grup financierësh, në bazë të një programi auditimi të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Peqin, të ushtrojë auditim për zbatimin e rregullshmërisë financiare në ish-Komunën Pajovë, për periudhën e viteve 2012-2015 dhe për përfundimet e këtij auditimi të njoftojë Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Brenda datës 30.05.2017

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Qeverisjes Vendore dhe Drejtori i Departamentit Juridik Zbatimit të Standardeve dhe Etikës .

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R